



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 7341 prot.

Himarë, më 29.09.2025

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

BANORËVE TË KOMUNITETIT TË QYTETIT HIMARË DHE FSHATIT VUNO,

Në zbatim të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si dhe mbështetur në rregulloren e Këshillit Bashkiak Himarë “Për konsultimet Publike”:

Ju njoftojmë se do të zhvillohet dëgjesa publike në kuadër të projekt vendimit; “Miratimin e vendit të depozitimit të dhera/inerte, në zonën e Vishës” që dalin nga gërmimet e objekteve”

Ftojme të gjithë grupet e interesit duke përfshirë por pa përjashtuar, qytetarët, bizneset, grupet e marginalizuara, të rinj/të reja dhe pjestarë të shoqërisë civile, të bëhen pjesë e dëgjesës për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Data: 20/10/2025

Ora: 11⁰⁰

Vendi: Fshati Vuno, Himarë.

Data: 21/10/2025

Ora: 11⁰⁰

Vendi: sala “Neço Muko”, Himarë

Takimi do të përqëndrohet në prezantimin e propozimit dhe diskutimet potenciale me komunitetin e zonës dhe grupet e interesit mbi pikëpamjet/propozimet dhe komentet në lidhje me projektin.

Mirëpresim komente, rekomandime, sugjerime dhe propozime të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme;

Adresa zyrtare e Bashkisë Himarë: info@himara.gov.al

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë Himarë dhe anëtar/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Himarë

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është e rëndësishme.

**KRYETARI
VANGJEL TAVO**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi

